

Performanca e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit dhe të dhunës në familje

NË GJASHTË MUJORIN
E PARË TË VITIT 2022



Shtator, 2022

1. Performanca e prokurorisë në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit dhe të dhunës në familje

(NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022)

 Dhunë në familje (neni 248)	PS Lëndë të trashëguara		I Lëndë të reja		LP Gjithsej lëndë në punë		R Lëndë të zgjidhura		PE Lëndë të pazgjidhura	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
	1431	1695	1468	2846	2899	3441	1540	1823	1359	1618

TABELA 1. Rastet e lëndëve të dhunës në familje në Prokurorin e Shtetit (1 janar - 30 qershor 2022).

 Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare (neni 414 - 430)	PS Lëndë të trashëguara		I Lëndë të reja		LP Gjithsej lëndë në punë		R Lëndë të zgjidhura		PE Lëndë të pazgjidhura	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
	393	1131	232	480	625	1611	170	353	455	1258

TABELA 2. Rastet lëndëve të korrupsionit në Prokurorin e Shtetit (1 janar - 30 qershor 2022).

Përlllogaritja e performancës së punës së organeve të sistemit të drejtësisë në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe të dhunës në familje nënkupton përcjelljen e evoluimit të rezultateve dhe vendosmërinë e këtyre organeve në parandalimin dhe luftimin e këtyre dukurive.

Në vijim janë paraqitur indikatorët matës të efikasitetit të punës së Institucionit të Prokurorit të Shtetit në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit dhe të dhunës në familje në gjashtë mujin e parë (janar-qershor) të vitit 2022. Ndërsa pasqyra e përgjithshme me të dhënat e sistemit prokurorial, në të cilët janë bazuar këta indikatorë, është paraqitur në tabelat e mëposhtme.

1.1 Fluksi i lëndëve

Shtatë prokuroritë themelore gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2022 kanë pasur në punë gjithsej 3779 lëndë të dhunës në familje (me 3441 persona të përfshirë), 1113 prej të cilave kanë qenë të trashëguara nga periudhat paraprake, ndërsa 2661 lëndë kanë qenë të reja të krijuara gjatë kësaj periudhe. Në këto shifra përfshihen edhe veprat penale të dhunës në familje të kryera nga kryerësit e mitur.

Ndërsa sa i përket lëndëve të korrupsionit, shtatë prokuroritë themelore dhe Prokuroria Speciale gjatë kësaj periudhe kanë pasur në punë gjithsej 625 lëndë (me 1611 persona të përfshirë), 393 prej të cilave kanë qenë të trashëguara nga vitet paraprake, ndërsa 232 lëndë të reja të krijuara gjatë kësaj periudhe.

Vepra penale LP (lëndë në punë) = PS (lëndë të trashëguara) + I (lëndë të reja)

Dhunë në familje  **3779** = 1113 + 2661

Korrupsion  **625** = 393 + 232

TABELA 3. Fluksi i lëndëve të dhunës në familje dhe të korrupsionit në Prokurorin e Shtetit (1 janar – 30 qershor 2022).

1.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate)

Norma e zgjidhjes së lëndëve është një indikator i rëndësishëm që tregon performancën e një prokurorie në zgjidhjen e lëndëve të shprehur në përqindje, si dhe tregon për kapacitetin punues të sistemit. Pra në kuadër të matjes, në këtë indikator nuk përfshihet numri i lëndëve të trashëguara nga viti paraprak, por vetëm lëndët e reja dhe lëndët e zgjidhura.

- **Norma ideale e zgjidhjes së lëndëve do të duhej të ishte 100 %, që nënkupton se sistemi zgjidh aq lëndë sa pranon gjatë vitit.**

Sipas tabelës së mëposhtme, norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në gjashtë muorin e parë të vitit 2022 në shtatë prokuroritë themelore dhe në Prokurorinë Speciale rezulton të jetë 73 %, ndërsa norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në shtatë prokuroritë themelore rezulton 105 %.

Vepra penale

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e reja (I)}} \times 100$$

Dhunë në familje

$$\frac{1540}{1468} \times 100 = 105\%$$

Korrupsion

$$\frac{170}{232} \times 100 = 73\%$$

TABELA 4.

Norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje dhe të korrupsionit në Prokurorin e Shtetit (1 janar - 30 qershor 2022).

1.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio)

Norma e qarkullimit të lëndëve mat raportin mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrit të lëndëve të në pritje të zgjidhjes. Pra kjo normë e mat frekuencën me të cilën sistemi prokurorial ose prokuroria e zëvendëson numrin e lëndëve të reja. Me fjalë të tjera, norma e qarkullimit të lëndëve mat se sa shpejt sistemi (në këtë rast i prokurorisë) i trajton lëndët që i pranon – që ndryshe i bie se sa shumë kohë merr sistemi për zgjedhjen e një lënde.

- **Norma ideale e qarkullimit të lëndëve do të duhej të ishte të paktën 1, që nënkupton se sistemi zgjidh po aq lëndë sa pranon gjatë vitit dhe nuk ka bartur asnjë lëndë për vitin e ardhshëm.**

Sipas tabelës së mëposhtme, norma e qarkullimit të lëndëve të dhunës në familje në gjashtë mujin e parë të vitit 2022 në shtatë prokuroritë themelore rezultojnë të jetë 1.13, ndërsa norma e qarkullimit të lëndëve të korrupsionit rezultojnë 0.37.

Vepra penale

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e reja (I)}}$$

Dhunë në familje

$$\frac{1540}{1359} = 1.13$$

Korrupsion

$$\frac{170}{455} = 0.37$$

TABELA 5.

Norma e qarkullimit të lëndëve të dhunës në familje dhe të korrupsionit në Prokurorin e Shtetit (1 janar - 30 qershor 2022).

1.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time)

Komisioni Evropian i Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) kërkon që sistemi i drejtësisë të raportoj një indikator të kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve të cilat kishin mbetur të pazgjidhura gjatë kësaj periudhe. Pra numri 181 është numri i ditëve të gjashtë mujorit të parë të vitit 2022, që pjesëtohet me normën e qarkullimit të lëndëve që ka rezultuar gjatë kësaj periudhe në Institucionin e Prokurorit të Shtetit.

Nga tabela e mëposhtme shihet se, nëse vazhdohet me këtë trend të zgjidhjes së lëndëve, Prokurorit të Shtetit i duhen edhe 160 ditë për të zgjidhur lëndët e dhunës në familje, që këtë periudhë kishin mbetur të pazgjidhura, ndërsa edhe 489 ditë për të zgjidhur lëndët e korrupsionit të pazgjidhura gjatë kësaj periudhe.

Vepra penale		Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve = $\frac{181}{\text{norma e qarkullimit të lëndëve}}$	
Dhunë në familje	$\frac{181}{1.13}$	= 160	
Korrupsion	$\frac{181}{0.37}$	= 489	

TABELA 6.

Norma e qarkullimit të lëndëve të dhunës në familje dhe të korrupsionit në Prokurorin e Shtetit (1 janar - 30 qershor 2022).

1.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Një prej problemeve kryesore që raportohet në sistemin e drejtësisë në Kosovë është numri i madh i lëndëve të grumbulluara ndër vite. Ky indikator determinohet nga numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, në pjesëtim me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese.

Ashtu siç shihet në tabelën e mëposhtme, në vitin 2022 në Prokurorin e Shtetit janë bartur gjithsej 1431 lëndë të dhunës në familje nga viti paraprak, si dhe 393 lëndë të korrupsionit.

Vepra penale

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara \%} = \frac{\text{Lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{Lëndët e zgjidhura (R)}}$$

$$\text{Dhunë në familje} \quad \frac{1431}{1540} = \mathbf{0.92}$$


$$\text{Korrupsion} \quad \frac{393}{170} = \mathbf{2.31}$$


TABELA 7.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara të dhunës në familje dhe të korrupsionit në Prokurorin e Shtetit (1 janar - 30 qershor 2022).

1.6 Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga ana e prokurorisë (për persona)

Ashtu siç është paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme, në gjyshtë mujorin e parë të vitit 2022 janë zgjidhur lëndët për 1823 persona të përfshirë në veprat penale të dhunës në familje dhe 353 personave të përfshirë në veprat penale të korrupsionit.

Për pjesën më të madhe të të akuzuarve për dhunë në familje, përkatësisht për 1392 persona, janë ngritur aktakuza, për 189 persona është hedhur kallëzimi penal, për 47 persona është pushuar hetimi, ndërsa për 195 persona lënda është zgjidhur në mënyra të tjera.


Ndërsa sa i përket lëndëve të korrupsionit, për 169 persona të akuzuar janë ngritur aktakuza, për 109 persona është hedhur kallëzimi penal, për 52 persona është pushuar hetimi, ndërsa për 23 persona të tjerë lëndët janë zgjidhur në mënyra tjera.

Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga ana e Prokurorit të Shtetit**Dhunë në familje****Korrupsion****Është hedhur kallëzimi penal****189 persona****109 persona****Është ngritur aktakuzë
(e drejtpërdrejtë, pas procedurës
hetimore, për urdhër ndëshkimor)****1392 persona****169 persona****Është pushuar hetimi****47 persona****52 persona****Është zgjidhur në mënyrë tjetër****195 persona****23 persona****TABELA 8.**

Mënyra e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje dhe të korrupsionit në Prokurorin e Shtetit (1 janar - 30 qershor 2022).

2. Performanca e sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit dhe të dhunës në familje

(NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022)



Dhunë në familje
(neni 248)

PS Lëndë të trashëguara	I Lëndë të reja	LP Gjithsej lëndë në punë	R Lëndë të zgjidhura	PE Lëndë të pazgjidhura
342	262	604	264	340

TABELA 9. Rastet e lëndëve të dhunës në familje në shkallën e parë të sistemit gjyqësor (1 janar - 30 qershor 2022).



Korrupsioni
zyrtar dhe veprat
penale kundër
korrupsionit
(414 - 430)

PS		I		LP		R		PE	
Lëndë të trashëguara		Lëndë të reja		Gjithsej lëndë në punë		Lëndë të zgjidhura		Lëndë të pazgjidhura	
Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
275	747	71	133	346	880	51	74	295	806

TABELA 10. Rastet e lëndëve të korrupsionit në shkallën e parë të sistemit gjyqësor (1 janar - 30 qershor 2022).

Në vijim janë paraqitur të dhënat e përgjithshme të pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, prej të cilave janë nxjerrur rezultatet nga indikatorët matës të efikasitetit të punës së shkallës së parë të sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit dhe të dhunës në familje në VI mujin e parë të vitit 2022.

2.1 Fluksi i lëndëve

Shtatë gjykatat themelore gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2022 kanë pasur në punë gjithsej 604 lëndë të dhunës në familje, 342 prej të cilave kanë qenë të trashëguara nga vitet e kaluara, ndërsa 262 lëndë të reja të krijuara gjatë kësaj periudhe. Pavarësisht se ne kemi kërkuar të dhëna edhe për numrin e personave të përfshirë në veprat penale të dhunës në familje nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës ne kemi pranuar të dhëna vetëm për numrin e rasteve.

Ndërsa sa i përket lëndëve të korrupsionit, shtatë gjykatat themelore kanë pasur në punë 346 lëndë (me 880 persona të përfshirë), 275 prej të cilave kanë qenë të trashëguara nga vitet paraprake, ndërsa 71 lëndë të reja të krijuara gjatë kësaj periudhe.

Vepra penale

LP (lëndë në punë) = PS (lëndë të trashëguara) + I (lëndë të reja)

Dhunë në familje



604 = 342 + 262

Korrupsion



346 = 275 + 71

TABELA 11.

Fluksi i lëndëve të dhunës në familje dhe të korrupsionit në Prokurorin e Shtetit (1 janar - 30 qershor 2022).

2.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate)

Sipas tabelës së mëposhtme, norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në gjashtë muorin e parë të vitit 2022 në shtatë gjykatat themelore rezulton të jetë 101 %, ndërsa norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit rezulton 72 %.

Vepra penale

Norma e zgjidhjes së lëndëve = $\frac{\text{Lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{Lëndët e reja (I)}} \times 100$

Dhunë në familje



$\frac{264}{262} \times 100 =$ **101%**

Korrupsion



$\frac{51}{71} \times 100 =$ **72%**

TABELA 12.

Norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje dhe të korrupsionit në shkallën e parë të sistemit gjyqësor (1 janar - 30 qershor 2022).

2.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio)

Sipas tabelës së mëposhtme, norma e qarkullimit lëndëve të dhunës në familje në 6 mujorin e parë të vitit 2022 në shtatë gjykatat themelore rezulton të jetë 0.77, ndërsa norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit rezulton 0.17.

Vepra penale		Norma e qarkullimit të lëndëve % = $\frac{\text{Lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{Lëndët e reja (I)}}$	
Dhunë në familje		$\frac{264}{340} = 0.77$	
Korrupsion		$\frac{51}{295} = 0.17$	

TABELA 13. Norma e qarkullimit të lëndëve të dhunës në familje dhe të korrupsionit në shkallën e parë të sistemit gjyqësor (1 janar - 30 qershor 2022).

2.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time)

Sipas rezultateve të matjes së këtij indikatori, nëse vazhdohet me trendin e njëjtë të zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit dhe të dhunës në familje, gjykatave themelore u duhen edhe 235 ditë për zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje, që këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura, si dhe edhe 1064 ditë për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit.

Vepra penale	Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve	=	$\frac{181}{\text{norma e qarkullimit të lëndëve}}$
---------------------	---	----------	---

Dhunë në familje	$\frac{181}{0.77}$	= 235	
-------------------------	--------------------	--------------	---

Korrupsion	$\frac{181}{0.17}$	= 1.064	
-------------------	--------------------	----------------	--

TABELA 14. Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje dhe të korrupsionit në shkallën e parë të sistemit gjyqësor (1 janar - 30 qershor 2022).

2.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Sipas rezultateve të këtij indikatori, të paraqitura në tabelën e mëposhtme, indeksi i lëndëve të grumbulluara të dhunës në familje gjatë këtij gjashtë mujori rezulton të jetë 1.29. Ndërsa indeksi i lëndëve të grumbulluara të korrupsionit rezulton 5.39.

Vepra penale	Indeksi i lëndëve të grumbulluara %	=	$\frac{\text{lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}$
---------------------	--	----------	--

Dhunë në familje	$\frac{342}{264}$	= 1.29	
-------------------------	-------------------	---------------	---

Korrupsion	$\frac{275}{51}$	= 5.39	
-------------------	------------------	---------------	--

TABELA 15. Indeksi i lëndëve të grumbulluara të dhunës në familje dhe të korrupsionit në shkallën e parë të sistemit gjyqësor (1 janar - 30 qershor 2022).

2.6 Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga ana e gjykatave themelore (për persona)

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2022, Gjykatat Themelore të Kosovës kanë nxjerrë aktgjykime fajësuese ndaj 567 personave të akuzuar për dhunë në familje dhe ndaj 34 personave të akuzuar për korrupsion.

Mënyra e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit dhe të dhunës në familje gjatë gjashtë mujorit të parë (janar – qershor) të vitit 2022 është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga ana e gjykatave themelore	Dhunë në familje	Korrupsion
Aktgjykim fajësues	567 persona	34 persona
Aktgjykim lirues	38 persona	10 persona
Është hedhur aktakuza para shqyrtimi gjyqësor	47 persona	1 person
Është refuzuar aktakuza	11 persona	2 persona
Është parashkruar lënda	11 persona	/

TABELA 16.

Mënyra e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje dhe të korrupsionit në shkallën e parë të sistemit gjyqësor (1 janar – 30 qershor 2022).